



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURES
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1259 Prot.

Tiranë, më 08.102018

VENDIM Nr. 212, datë 05.10.2018

Në mbështetje të **Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"**, Neni 134, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 9, datë 05.10.2018, pasi shqyrtoi **Projekt-Vendimin** për deklarimin pasuri kulturore arkeologjike të qytetit të Elbasanit; përcaktimin e zonës arkeologjike "A" dhe miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e saj, shoqëruar me Hartën me Zonën Arkeologjike "A" me koordinata, të qytetit të Elbasanit, paraqitur nga ASHA dhe IMK,

VENDOSI:

1. Të miratojë **Projekt-Vendimin** për deklarimin pasuri kulturore arkeologjike të qytetit të Elbasanit; përcaktimin e zonës arkeologjike "A" dhe miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e saj, shoqëruar me Hartën me Zonën Arkeologjike "A" me koordinata, të qytetit të Elbasanit, paraqitur nga ASHA dhe IMK.
2. Të vijojë nga ASHA procedura për përcjelljen e dokumentacionit përkatës të sipërpërmendur, me qëllim daljen e Vendimit të Këshillit të Ministrave në lidhje me to.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTËR



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al